

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kryeministër karton"/ Përplasje Rama-Bardhi në Kuvend: Nuk pyes për mendjet "e ndritura" të opozitës
ADRESA	https://www.cna.al/politike/kryeminister-karton-perplasje-rama-bardhi-ne-kuvend-nuk-pyes-per-mendje-i474518
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:37:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 06:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fbd92d4b22f7a62a5ee4b628315861f4631f0e816c279d7fb5ccd8f5fc55dc7
TEKSTI	18d9769f28b3be3342582ab3944597b784909fc36192a6df18f10b0a3e17d22e
PAMJA	e579b27f98011e5ee846571a5a3689375e69a08cac5bc7aa2f628371c1712a9d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	69dcadf0a2c9e7fb30c370318471a3f9553831b0336a12c083a58f5927b4b17c
E MËPARSHMJA	49ba143ab2c906f2eb0d611a3a572358e070117648b24506343780233175ffbd
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/69dcadf0a2c9e7fb30c370318471a3f9553831b0336a12c083a58f5927b4b17c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

09:02 Politikë

Kryeministri Edi Rama ka paralajmëruar propozimin e një li...

“Kryeministër karton”/ Përplasje Rama-Bardhi në Kuvend: Nuk pyes për mendjet “e ndritura” të opozitës



18 Shtator 2026, 08:35, Politikë CNA



Seanca plenare e së entjes, që zgjati deri në orët e vona, u shoqërua edhe me përplasje mes mazhorancës dhe opozitës.



Votimi në orët e vona/ Miratohet projektligji për pagat e magjistratëve

Një prej tyre ishte ajo mes kryeministrit Edi Rama dhe kreut të Grupit Parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi.

Demokrati, që nisi këtë diskutim me Ramën, e cilësoi këtë të fundit si kryeministër karton dhe i cilësoi si të turpshme disa deklaratatë të kryeministrit për ndikim e arbitrazhit në buxhetin e shtetit.

Në përgjigje ndaj Bardhit, kryeministri u shpreh me ironi se e zgjedh vetë mënyrën se si i ndan qasjet e tij mbi çështje të caktuara dhe se nuk pyet mendjet "e ndritura" të opozitës.

Pjesë nga debati:

Gazment Bardhi: *Mendova që edhe sot do të ishte thjesht kryeministër karton, por mirë që e more tre minuta fjalën që të justifikosh që nuk të ka kthyer Taulanti thjesht në karton që vjen në Kuvend sa herë u duhet vota këtyre. Së dyti, subjekti në fjalë ka zero interes për ne si opozitë. Ajo që ti këtu deklaron përpara shqiptarëve dhe Kuvendit ka shumë rëndësi. Fillimisht the që s'ka vendim arbitrazhi. Doli që kishte vendim arbitrazhi. Fillimisht the që subjekti në fjalë ka marrë zero lekë nga buxheti i shtetit. Pas 30 sekondash, 'ato që i ka marrë nga Albcontrol-i', a thua se ato nuk janë të shqiptarëve dhe të buxhetit të shtetit, 'do t'i kthejë kokërr më kokërr'. Pra, do të thotë që kthehet një gjë që është marrë, se në qoftë se nuk është marrë, nuk ka çfarë kthen.*

Por do bëje mirë që t'i përgjigjeshe akuzës së kolegut, jo për këtë çështje, se këtë çështje ke 10 vjet që na thua 'do t'i ndodhë një gjë atij, se ai po hetohet'. E kemi dëgjuar këtë përrallë dhjetëra herë këtu në seancë plenare. Sot mendova që do merje fjalën dhe do na shpjegoje pse po shkel vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pse ke futur në kolaps sistemin e drejtësisë. Mendova se do të na shpjegoje pse i ke dhënë Roni Yeffet 34 milionë euro dhe thua 'nuk kam lekë për t'u paguar pagat gjyqtarëve dhe prokurorëve'. Mendova se kishe ardhur të shpjegoje këtë.

Po për t'u marrë me subjektin në fjalë, ke nja 14 vite deri tani. S'ia ke dalë, për fatin e keq të Shqipërisë, se ato lekë nuk janë të tuat, edhe pse veprimet janë të papërgjegjshme, të tuat personale dhe të rrethit tënd të ngushtë, siç thotë vendimi i arbitrazhit. Por ato lekë janë të shqiptarëve dhe unë ndiej keqardhje që ai zotëria, për papërgjegjshmëri të qeverisë që ti drejton, u merr paratë qytetarëve të varfër shqiptarë, në vend që t'i çojmë për rritje pensionesh e për rritje rrogash për qytetarët shqiptarë e për ndihmë më të lartë ekonomike për familjet e varfra dhe që s'kanë bukë të hanë çdo ditë.



Por se çfarë marrëdhënie ke ti me të, herë miqësi, herë pastaj ta prishi, herë do ta fusësh në burg, herë e kërkon drejtësi, për momentin ai ka marrë lekët e shqiptarëve për shkak të papërgjegjshmërisë tënde, e përsëris, i ka futur në xhep. Do të kthehen? S'dimë a do të kthehen apo jo, se nga 's'ka marrë' te 'do kthehen' është një hapësirë shumë e madhe. Por, meqë ke ardhur në seancë, përgjigju pse shkel në mënyrë të vazhdueshme vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë? Për këtë do të duhet t'i jepni llogari Parlamentit.

Edi Rama: *Winston Churchill thoshte se hajvani është dikush që jo vetëm nuk ndryshon mendje, por nuk ndryshon as argument. Ndërkohë që unë jam këtu prezent me zërin tim, e dëgjuan të gjithë, unë thashë që ai ka marrë dhe ka për të marrë zero lekë. Nuk thashë, sepse nuk ka ndodhur, se po të ndodhte kjo do ishte në librat e llogarive të shtetit shqiptar, që ai ka marrë dhe do t'ia marrim mbrapsht. Unë thashë që ai ka marrë zero lekë. Fondi është një fond i ngrirë deri në fund të procesit.*

Pikërisht sepse, ndryshe nga çfarë mendoi ai që u kthye në heroin e këtyre këtu, që nuk lënë pleh pa e kthyer në hero për të sulmuar me çdo kusht dhe me çdo çmim, edhe me çmimin e përbaltjes së Shqipërisë, palën tonë. Ndërkohë që sot, pikërisht pse çështja e arbitrazhit nuk u mbyll ashtu sikundër ëndërronte ai subjekt, ne jemi në disa procese dhe zero lekë ka marrë, zero lekë do të merren. Kjo është e vërteta.

Për sa u përket pastaj 34 milionëve e 450 milionëve, e 70 milionëve, e 80 milionëve, kjo është një përpjekje shumë e vjetër që ka po të njëjtin rezultat: rrokanisje pa fund kokës së shqiptarëve dhe, në fund, ballit nga shqiptarët sa vijnë zgjedhjet. Dhe përsëri shqiptarët ballit, sa vijnë zgjedhjet, do t'ju japin për të gjitha këto që bëni. Sepse sa më shumë t'i mermi për budallenj, aq më shumë do ta mermi ballit nga shqiptarët në çdo palë zgjedhje. Kjo është e vërteta.

Për sa i përket pastaj çështjes në fjalë, unë do të flas, patjetër që do të flas, dhe do të flas kur dëshiroj unë, jo kur vendosni ju. Po do të flas, këtu jam për të folur. Po dëgjoj njëherë të gjitha mendjet "e ndritura" të mendimit juridik të Parlamentit dhe pastaj do të them dhe unë ato që mendoj si një piktor "i rëndomtë". /CNA





Të sugjeruara

Berisha, me dy qëndrime për Gjykatën Speciale/ Ish-deputeti: Dokrra për përfitime politike

Votimi në orët e vona/ Miratohet projektligji për pagat e magjistratëve

"Përplasja" e magjistratëve me qeverinë/ Berisha: Rama u soll si bandit, u bllokoi thesarin

Rama dhe Sadushi në Vajzë/ Berisha: U trallisën bashkë

Projektligji për magjistratët/ Manja ironizon opozitën: Mos bëni sikur iu digjet shpirti

Berisha: Basha kishte dorë në vendosjen e sanksioneve ndaj meje

Reagimi i Ramës për vendimin e Hagës/ Berisha: Lau duart, me fjalët e një plake

Berisha në dy kohë/ Thaçi nga argat i Beogradit, në hero të Kosovës

"Fundi do të jetë i dhimbshëm"/ Zhupa: Kuvendi reflekton vetëm dëshirat e Edi Ramës

"72 vota kundër një rezolute për gjenocidin serb në Kosovë"/ Muçollari: Do të mërzhiste Vuçiç

Balla-opozitës: Këtë teatrin që ju jeni atdhetarë e ne tradhtarë lëreni për një kohë tjetër

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Kuvendi i Shqipërisë deklaratë të përbashkët: Tërësisht i padrejtë

“Shko pi kafe”/ Këshilla e Berishës për ministren e Shëndetësisë

Ministrja Spahiu bën zotim: O sjell PET-Scanin deri në fillim të 2027, o jap dorëheqjen

Debatet PS-PD për vendimin e Hagës/ Ish-deputeti: Eufori për të gjetur tradhtarin, të shihen zgjidhjet

Audio-përgjimet për Ron Yeffet/ Këlliçi në Kuvend: Rama, i përfshirë drejtpërdrejt në trafikun e armëve

Berisha në Kuvend: Rama dhe Vuçiç, përgjegjës direktë për dënimet e Hagës

Rezultatet e PISA-s për arsimin/ Përplasje Boçi-Kumbaro në Kuvend

Shtyhen dy interpelanca në Kuvend/ Ja arsytet


“Doli profecia e Berishës”/ Noka, llogari Ramës: Trego pse kërkoje votimin e Gjykatës Speciale

[editorial](#)

19:39 Editorial

Burri Hashim Thaçi dhe burreci Veliaj

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

13:25 Opinione Lutfi Dervishi

Kurbani i fundit për Kosovën/ Drejtësia e lupës politike dhe dora e historisë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.